

Gjykata themelore –Divizioni kundërvajtës ne Prizren, me gjyqtarin Zejnulla Gashi ,dhe procesmbajtësen Melihate Shaipi, ne procedurën kundërvajtës kundër te pandehurës Kimete Hoxha nga Prizreni , per shkak te kundërvajtjes nga neni 5 , 6, par. 1 pik 3, si dhe nenit 9 te Lidhur me nenin 17 par. 1 pika 3 te Ligjit nr. 04/L-050 per Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë dhe te zyrtareve te Larte publik dhe ,deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e dhuratave për te gjithë personat zyrtar , e ne baze te nenit 195 al. 1 te LMK, me dt. 08.01.2013 . mori

## A K T V E N D I M

E pandehura Kimete Muhamet Hoxha , e lindur ne vitin 1959, ne Prizren rr`` Ulqinit `` nr. 96, me kombësi shqiptare , Shtetas e Republikës Kosovës, këshilltarë e asamblesë, e martuar, nena e tre fëmijëve, e gjendjes se mesme, ka te kryer shkollën fillore

## E S H T E P E R G J E G J E S E

Për shkak se e njëjta ne cilësinë e zyrtares se larte publik nuk ka përmbushur obligimin ligjor qe parashihet ne Ligjin nr. 04/L-050 , për Deklarimin , prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë dhe te zyrtareve te Larte publik.

-me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5 , 6, par. 1 pik 3, si dhe nenit 9 te Lidhur me nenin 17 par. 1 pika 3 te Ligjit nr. 04/L-050 per Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë dhe te zyrtareve te Larte publik dhe ,deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar, I shqiptohet masa

## Q O R T I M

### A r s y e t i m

Sipas kërkesës te Agjencisë kundër korrupsionit Prishtine me numër 01-1893/2012 te datës 24.05.2012. është ngritur procedura kundërvajtjes kundër te pandehurës Kimete Hoxha nga Prizreni , per shkak te kundërvajtjes nga neni 5 , 6, par. 1 pik 3, si dhe nenit 9 te Lidhur me nenin 17 par. 1 pika 3 te Ligjit nr. 04/L-050 per Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë dhe te zyrtarëve te Larte publik dhe ,deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e dhuratave për te gjithë personat zyrtar,

Gjendja faktike e përshkruar me për se afërmi sikurse ne dispozitiv te këtij aktvendimi është vërtetuar ne baze te deklaratës se te pandehurës Kimete Hoxha , e cila ne deklaratën e dhënë ka mohuar kundërvajtjen me te cilën ngarkohet duke u arsyetuar se nuk ka qene e njoftuar nga zyrtari përgjegjës komunal lidhur me obligimin ligjor sa I përket deklarimit te pasurisë pranë agjencisë kundër korrupsionit ne Prishtine , per ndryshe sipas saj ne momentin e njoftimit dhe dorëzimit te formularit ajo e ka plotësuar formularin ne fjale , te njëjtën ne kopje ka dorëzuar gjykatës si dëshmi .

Gjykata ka dëgjuar dëshmitarin Agron Behrami ne cilësinë e shefit te divizionit te AKK-se I cili ka deklaruar se ne muajin mars 2012 agjencia kundër korrupsionit ka shpërndarë njoftimin te gjithë zyrtarëve kontaktues përmes imejlit dhe ka kërkuar qe te njoftojnë anëtarët e Kuvendit Komunal si dhe te iu dorëzohet formulari per deklarimin e pasurisë .

Gjykata ne seancën dëgjimore ka thirre personin përgjegjës ne Kuvendin Komunal , ne cilësinë e dëshmitarit , Ibrahim Krasniqi I cili ka deklaruar se I ka njoftuar te gjithë zyrtaret e larte ne Kuvendin Komunal si dhe fizikisht ia ka dhënë Kimete Hoxhes formularin per deklarimin e pasurisë mirëpo, ia ka dhënë formularin e vjetër e jo formularin e ri sipas ligjit te ri nr. 04/L-050 .

DPK / DMP  
02

03-231/2013  
01.02.2013

03-231/2013 /02  
Skuq

Gjykata pas administrimit te provave shqyrtimit te kërkesës te iniciuar nga parashtruesi I kërkesës dhe duke u bazuar ne deklaraten e te pandehurës si dhe deklaratat e zyrtarëve vije ne përfundim se zyrtari përgjegjës pranë Kuvendit Komunal nuk e ka kryer punën e tij ne mënyre te rregullt per arsye se ne deklaraten e dhëne ka pranuar se anëtares se Kuvendit Komunal Kimete Hoxhes ia ka dhëne formularin e vjetër e jo formën e re sipas ligjit te ri me numër 04/L-050, andaj e ka marre si rrethane lehtësuese .

Gjykata ne baze te nenit 10 te LMK lidhur me nenin 7 te LMK, te pandehurit i shqipon masën Q O R T I M me bindje se edhe me këtë mase , ne vend te gjobës se parashikuar me ligj do te arrihet qëllimi i tij dhe e pandehura ne te ardhmen nuk do te kryej kundërvajtjen te kësaj natyre.

Me sa u cek me larte, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDËRVAJTJE NE PRIZREN

Nr. 478 -05/2012


Procesmbajtësja

Melihate Shaipi

te dt. 08.01.2013.

Gjyqtari

Zejnulla Gashi



UDHZIMI JURIDIK : Kundër këtij aktvendimi , mund te ushtrohet ankese , ne afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit te te njëjtit, Gjykatës se Larte per Kundërvajtje ne Prishtinë, nëpërmjet te kësaj gjykate , pa taksa.